



Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21) dhe nenit 23, paragrafi 2 të Ligjit të Veprimtarisë me Valuta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

V E N D I M

**për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 89/22)**

1. Në Vendimin për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët të cilët nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 50/19, 181/19, 167/20, 308/20, 88/21, 177/21 dhe 247/21), në pikën 2, pas nënpikës 2.14 shtohet nënpikë e re 2.15, si më poshtë:

"2.15. Personat juridikë rezidentë që kanë një detyrim për të paguar në bazë të shitjes së mallrave ose shërbimeve ndaj një personi juridik nga Federata e Rusisë, për të cilat rregulloret e këtij vendi e detyrojnë rezidentin të çelë një llogari në një bankë të huaj për pagesën e këtyre mallrave ose shërbimeve.

Detyrimi nga paragrafi 1 të kësaj nënpike vërtetohet me dorëzimin e një dokumenti origjinal ose fotokopje të vërtetuar nga organi kompetent - noteri, nga i cili do të mund të përcaktohet detyrimi i rezidentit për të kryer pagesën ndaj personit juridik në Federatën e Rusisë.

Llogaria në bankën e huaj e çelur për detyrimet e paragrafit 1 të kësaj nënpike mund të shfrytëzohet vetëm për transferimin e mjeteve jashtë vendit deri në shumën e detyrimit për t'i paguar personit juridik dhe vetëm derisa është në fuqi rregullorja e paragrafit 1 të kësaj nënpike".

2. Ky vendin hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

O nr. 02-15/VI-1/2022
6 prill 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska